



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.12.2020)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 15:47 dhe mbaroi në orën 15:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Fatmira Luli* (anëtare)
4. *Brunilda Kadi* (anëtare)
5. *Ilir Toska* (anëtar)
6. *Alban Toro* (anëtar)
7. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
8. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Medi Bici*, z. *Dritan Hallunaj* dhe znj. *Marçela Shehu*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

*Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 21.12.2020*

3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.

4. Klodian Kreçi, Shef pranë Sektorit të Standardeve dhe Infrastrukturës së IT-së.

RENDI I DITËS:

1. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.¹

Objekt i kësaj mbledhjeje urgjente e Këshillit të Lartë Gjyqësor është trajtimi i çështjes “Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Relator i kësaj çështjeje të rendit të ditës është zoti Ilir Toska.

Shkurtimisht parashtrohet se ditën e sotme ka mbërritur pranë Këshillit një kërkesë urgjente nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat

Trajtohet relacioni për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jenë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Gjithashtu Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti gjyqtarja: Nertila Kape.

Në shortimin e çështjes, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e ngarkesës

¹ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

relativisht të ulët të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të saj, të mos përjashtohen nga shorti Kryetari në detyrë i kësaj gjykate, konkretisht: z. Edvan Veçani.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, gjyqtar Ardit Kuka.

Me kaq mbyllet procedura e shortit dhe kjo çështje e rendit të ditës.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor